



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0753

PSH. nr. 753/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Med Plus”SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor për nevojat e KPSH “ me nr. të prokurimit: "616-23-9366-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës me datën 08.11.2023, mori këtë:

Vendim

I. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Med Plus” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 02.10.2023 (me numër protokolli 753/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor për nevojat e KPSH “ me nr. të prokurimit: "616-23-9366-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

II. AK i lejohej të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

III. Meqenëse ankesa e OE ankues është refuzuar si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 01.09.2023, Komuna e Prishtines , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor per nevojat e KPSH” me nr. të prokurimit:” 616-23-9366-1-1-1.

OE “Med Plus” SH.P.K. me datën 19.09.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 22.09.2023, AK-Komuna e Prishtines me vendim ka refuzuar si te pa bazuar kërkesat per rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Med Plus” SH.P.K. me datën 02.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 753/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 200.000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 12.10.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Med Plus” SH.P.K.

I. Refuzohet, ankesa e operatorit ekonomik “Med Plus” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 02.10.2023 (me numër protokollit 753/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor per nevojat e KPSH “ me nr. të prokurimit: "616-23-9366-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines.

II. AK i lejohe të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Me dt. 01.09.2023 është publikuar njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit me titull “Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor për nevojat e KPSH-së”. Ne si palë e interesuar për të ofertuar në këtë projekt, e kemi analizuar dosjen e tenderit në tërësi dhe njoftimin për kontratë, ndërsa kemi vërejtur se

janë vendosur kërkesa diskriminuese/favorizuese në dosje të tenderit, të cilat do ti sqarojmë më poshtë: 4/6 Fillimisht në lidhje me kërkesat të cilat janë kërkesa diskriminuese/favorizuese, ne kemi parashtruar kërkesë për informacione shtesë ku i kemi kontestuar disa nga kërkesat e dosjes së tenderit kurse për disa kemi kërkuar sqarime, mirëpo autoriteti kontraktues na ka kthyer përgjigje duke mos i marr parasysh fare sqarimet tona. Andaj jemi të detyruar të parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim pasi që me kërkesat të cilat janë specifikuar në dosje të tenderit kufizohet konkurrenca dhe ju pamundësohet ofertimi OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit.

1. Tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 9.1&9.2 ju keni kërkuar “2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a) Një menaxher projekti me profesion farmacist me 5 vite përvojë pune; b) Një Teknik I farmacisë me 5 vite përvojë pune”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “a) Për menaxherin CV , Diplomë Universitare (Fakulteti i mjekësisë-dega farmaci), Licenca e farmacistit, Kontrata dhe CV e Nënshkruar nga vetë menaxheri. b) Teknik të farmacisë së paku diploma e shkollës së mesme kontrata dhe licenca”. Në lidhje me këtë kërkesë, në kërkesën për informata shtesë kemi kërkuar që të largohet kërkesa prej 5 viteve përvojë pune për teknikun e farmacisë, sepse e njëjta kërkesë nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit ose të largohet në tërësi kërkesa për teknik të farmacisë, pasi që po kërkohet farmacisti dhe në këtë rast kemi të bëjmë me furnizime e jo shërbime dhe nuk ka nevojë të jetë kjo kërkesë e dosjes së tenderit. Në përgjigjen e AK-së në lidhje me pyetjen tonë, e njëjta ka dhënë përgjigjen si në vijim: “Kërkesa që tekniku i farmacisë të ketë përvojë pune është kërkesë ligjore pasi që çdo depo farmaceutike duhet për tu licencuar nga AKPPM-ja si qarkullues, të ketë Farmacistin dhe Teknikun kurse për përvojën e punës është e drejtë e AK-së të kërkojë pasi që tekniku merret me përgatitjen e produkteve dhe janë produkte të ndjeshme dhe duhet të kemi liferimin sipas PSO nga depo farmaceutike në depon e QKMF-së dhe QMU[1]së pra sipas rregullave të parapara”. Përgjigjja e autoritetit kontraktues, nuk është bindëse dhe e qëndrueshme dhe nuk e arsyeton kërkesën për teknik të farmacisë dhe përvojën e kërkuar. Arsyetimi se tekniku merret me përgatitjen e produkteve dhe kërkesa për përvojë të punës nuk janë në harmoni njëra me tjetrën, e po ashtu përgatitja e produkteve nuk do të thotë se duhet të bëhet nga një teknik i farmacisë me përvojë punë aq të madhe, madje nuk nevojitet fare prezenca e teknikut kur kemi parasysh faktin se kërkesë e dosjes së tenderit është edhe farmacisti. Andaj kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa në lidhje me teknikun e farmacisë ose përvoja e kërkuar për të njëjtin, pasi që siç edhe e kemi cekur në këtë aktivitet të prokurimit kërkesë e dosjes së tenderit është edhe farmacisti dhe kur dihet që në këtë rast kemi të bëjmë me furnizime e jo shërbime është i qartë fakti se nuk ka nevojë të përcaktohet një kërkesë e tillë në dosje të tenderit. Furnizimet që duhet të bëhen janë përgjegjësi e operatorit ekonomik, i cili ka farmacist në kuadër të kompanisë prandaj arsyetimi i AK-së kinse posedimi i një tekniku krijon garanci për furnizim është më të vërtetë një paradoks sepse përgjegjësitë e palëve kontraktuale janë derivat i kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës dhe nëse nuk zbatohet kontrata atëherë parashihen masat ligjore. Pra posedimi i një tekniku të farmacisë nuk është garancë se furnizimi do të bëhet në mënyrë të drejtë dhe korrekte por janë elementet tjera që garantojnë furnizimin korrekt 5/6 dhe adekuat, siç janë kontrata, sigurimi i ekzekutimit etj.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1.

Eksperti shqyrtues, sqaron se në lidhje me kërkesën e AK, për angazhimin e personelit profesional të cilin duhet ta kenë kualifikimet shkollore, siç është kërkuar që menaxher i projektit me profesion farmacist me 5 vite përvojë pune, kjo është kërkesë legjitime e AK, për arsyen që natyra e kësaj fushe është e ndjeshme dhe kemi të bëjmë me barna dhe furnizime me material shpenzues mjeksor, në lidhje me këtë kërkesë është përgjegjësi e AK, që të kërkojë kualitetin dhe përgaditjen e stafit. Andaj, eksperti shqyrtues mendon që me të drejtë AK, ka kërkuar që të kenë përvojën e mjaftueshme dhe konstatoj që kjo kërkesë nuk është favorizuese/diskriminuese për ndonjë OE, por është konform LPP përkatësisht nenit 69 pika 4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që

drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve; Këtë e parasheh edhe Udhëzuesi 001/2023, i Prokurimit Publik, Në rast të kontratës për ofrimin e shërbimeve: a) Kualifikimet minimale profesionale dhe edukative të stafit menaxheriale a. Lista e kualifikimeve profesionale dhe edukative dhe CV-në e tyre, Minimumi i mesatares së fuqisë punëtore për secilin nga 3 vitet, pra në rastin konkret AK, ka kërkuar përvojën e menagjerit profesional farmacist me 5 vite përvojë pune konform rregullave të PP, ky pretendim i OE ankues i hudhet posht si i pa bazuar.

2. Në dosje të tenderit po ashtu është specifikuar kërkesa si në vijim “7.Operatori Ekonomik ofertues se bashku me ofertë, duhet që të sjellë nga një moster për lloj te produktit.(poz 113,132,168,169,175)”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “7.(Mostrat duhet të dorëzohen para hapjes së tenderit”. Sa i përket mostrave ne në kërkesën për informata shtesë kemi parashtruar pyetjen dhe sqarimin si në vijim: Mostrat janë kërkuar për produktet (poz 113,132,168,169,175). Kërkojmë që të largohet kërkesa për të ofruar mostra vetëm për këto produkte sepse po tingëllon tendencioze dhe nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Sipas neve si profesionistë të kësaj fushe, këto pozicione nuk janë më të rëndësishme se pozicionet tjera, prandaj konsiderojmë se kërkesa e tillë është e panevojshme. Po ashtu OE plotësojnë dhe nënshkruajnë deklaratën për specifikime teknike. Autoriteti kontraktues ka dhënë sqarimin si në vijim: “Kërkesa për ofrimin e mostrave është kërkesë për tu verifikuar saktësia e produktit dhe kualiteti për këto pozicione dhe kjo kërkesë është e drejtë e AK-së të bëjë kërkesën për këto mostra pasi për shkak se ne nuk kemi dashur të vështirësojmë ofertimin, duke kërkuar mostrat vetëm për këto pozicion”. Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, për faktin se ne si ekspert të kësaj fushe, e dijme që pozicionet tjera janë shumë më të rëndësishme se sa pozicionet për të cilat janë kërkuar mostrat. Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë një përgjigje konkrete në lidhje me këtë pyetje, ndërsa sa i përket arsyetimit të AK-së ku e njëjta e ka cekur se “ne nuk kemi dashur të vështirësojmë ofertimin, duke kërkuar mostrat vetëm për këto pozicion”, ju sqarojmë se nëse eventualisht nuk është dashur të vështirësohet ofertimi, atëherë nuk është dashur të kërkohen fare mostrat, mirëpo vetëm deklarata për specifikime teknike. Andaj kërkojmë edhe një herë që të largohet kërkesa në lidhje me mostrat e kërkuara vetëm për produktet (për poz 113,132,168,169,175), pasi që siç edhe e kemi cekur një kërkesë e tillë është diskriminuese dhe ju pamundëson ofertimin OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht është kërkesë e cila favorizon OE të caktuar. Pra kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa në lidhje me prezantimin e mostrave vetëm për produktet e caktuara, pasi që kërkesa e tillë është tendencioze dhe favorizuese për OE të caktuar. Po çka përmbajnë pozicionet që janë kërkuar mostrat. 113 Batanije per shpëtim-Folije termike; Pershkrimi: Pajisje për një përdorim, batanije e hollë, sikur foli alumini. Mbron nga të ftohtit/nxehtësia Copë 1 132 Compres gaza 100cm x 80cm Copë 1 168 Letër për EKG Schiller AT-1 90x90 x400 Copë 1 169 Letër për EKG Schiller AT -2 210 x 280 x 216 Copë 1 175 Mouthpiece per spirometer nje perdorim Copë 1 Produkti 113 është batanije dhe është për një përdorim dhe kërkohet mostra, mirëpo kjo mostër nuk ka asnjë rëndësi sepse nuk është ndonjë produkt që ka ndonjë specifikë dhe rëndësi të veçantë. 6/6 Të kërkohet mostër për një batanije që është vetëm për një përdorim nuk ka se si të kuptohet përveç si tendencë dhe favorizim, e sidomos kur kem parasysh faktin se në këtë tender kemi furnizime edhe me penjë kirurgjik, teste të shtatzënisë, qese urinare, katetera, sonde, termometër, e nuk janë kërkuar mostra. Po ashtu kërkohet mostër për compres gaza tek Nr.132, ndërsa për compres gaza Compres gaza(gaza sterile) 60x60cm për kirurgji te vogla tek nr.131 nuk kërkohet edhe pse kjo compres është më specifike dhe më e veçantë. Favorizimi i hapur dhe tendenca shihet shumë qartë, kur kërkohet mostër për produktet 168 dhe 169 letër për EKG, ndërsa nuk kërkohet për produktin 170 dhe 171 e që janë edhe këto letra për EKG. Shtrohet pyetja përse paskan rëndësi më të madhe letrat për EKG e kërkuar në pozicionin 168 dhe 169 e nuk paskan rëndësi letra për EKG tek produkti nr.170 dhe 171. Kjo kërkesë është më të vërtetë absurditet i llojit të vet. Kërkesat për mostra janë absolutisht të panevojshme, për më tepër ku prej 189 artikujve kërkohen mostrat për pesë artikuj, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të analizohen profesionalisht këto kërkesa, e edhe për këto produkte të largohet kërkesa për mostra. Vetë autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës në dy aktivitet të kaluara, të njëjta me këtë aktivitet nuk ka kërkuar mostra. Me poshtë janë aktivitetet e kaluara: Aktiviteti prokurimit nr.1 AK: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES Nr i prokurimit: 616-22-2096-1-1-1 Titulli: Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësor për QKMF dhe QMU Vlera e parashikuar: Totali: 480,000.00 € Kjo kontratë

publike kornizë ka kohëzgjatje prej 36 muajsh Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit: 17.03.2022 Aktiviteti prokurimit nr.2 AK: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES Nr i prokurimit: 616-23-3329-1-1-1 Titulli: Furnizim me barna për nevojat e Kujdesit Shëndetësor dhe Shtëpisë së Pleqëve Vlera e parashikuar: Totali: 238,403.67 € Lot 1: 200,000.00 € (Furnizim me barna për nevojat e Kujdesit Shëndetësor) Lot 2: 38,403.67 € (Furnizim me barna për nevojat e Shtëpisë së Pleqëve) Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 12 muajsh Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit: 06.04.2023 Pra edhe në vitin 2022, mirëpo edhe në vitin 2023 për furnizime të njëjta dhe të ngjashme nuk ka kërkuar mostra ndërsa tani i kërkon vetëm për pesë produkte dhe pa mundur të arsyetojë pse kërkohen mostrat vetëm për këto produkte.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2.

Eksperti shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues mjaftueshem e ka sqaruar arsyen e kësaj kërkesë mandej kjo është e lejuar edhe me Rregullore Nr.001/2022, për Prokurim Publik Nenit 37.2 Kur kërkohen mostrat ato mund të dorëzohen paraprakisht, ose gjatë kohës së mbylljes së tenderit. Ato duhet të dorëzohen para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, si dhe neni 32.5 Tenderët mund të shoqërohen me dokumente në formë fizike, si: mostrat, katalogjet dhe çfarëdo dëshmie tjetër e cila nuk mund të ngarkohet përmes sistemit elektronik të prokurimit, mirëpo gjatë hartimit të ofertës elektronike operatorët ekonomik duhet t'i specifikojnë dokumentet të cilat dërgohen në formë fizike. Arsyen e kërkesave për ofrimin e mostrave para hapjes së tenderit e ka dhënë edhe AK, pra për tu verifikuar saktësia e produktit dhe kualiteti për pozicionet e caktuar. Në disa raste, AK mund të specifikojë funksione të dëshirueshme, performancë etj., dhe të përfshijë specifikime të tilla në kritere, mbi të cilat tenderuesit vlerësohen (parametrat e konkurrencës). Andaj, në këtë rast AK, nuk ka bërë asnjë favorizim për asnjërën pal në procedur, andaj këtë obligim e kanë të gjithë Operatorët Ekonomik të cilet shprehin interesim për këtë akitivitet të prokurimit.

3. Tek informatat shtesë ne e kemi sqaruar edhe çështjen sa i përket kërkesës 3. 7/6 6. Operatori ekonomik duhet te dorëzoje Certifikatat e Prodhuesit ISO 13485 ose 9001 dhe CE Certifikata për materialin shpenzues medicinal. Në lidhje me këtë kërkesë ne e kemi cekur se “Kërkojmë që të largohet kërkesa për ISO dhe CE për materialet shpenzuese tek pika 6, sepse për materialet shpenzuese të klasës I kërkohen deklaratat e konformitetit. Produktet që parashihen të furnizohen në këtë tender dihet që pa ISO dhe CE nuk mund të importohen dhe realisht janë të panevojshme këto kërkesa”. Autoriteti kontraktues ka dhënë përgjigjen si në vijim “Ju në ofertë duhet të prezantoni ISO dhe CE (për produktet që nuk kanë CE mund të paraqitni certifikatë të konformitetit sipas rregullave të AKPPM-së dhe BE-së për verifikimin e cilësisë së produkteve me Certifikata)”. Përgjigjia e AK-së është e paqëndrueshme dhe jo konkrete në lidhje me pyetjen tonë, andaj ne edhe nga OSHP-ja kërkojmë që të largohet kërkesa për ISO dhe CE për materialet shpenzuese tek pika 6, sepse për materialet shpenzuese të klasës I kërkohen deklaratat e konformitetit. Produktet që parashihen të furnizohen në këtë tender është e qartë se të njëjtat pa ISO dhe CE nuk mund të importohen dhe realisht janë të panevojshme këto kërkesa, të parapara nga AK-ja, andaj kërkojmë të largohen nga dosja e tenderit dhe të publikohet formulari standard për korrigjimin e gabimeve.

4. Sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit ku është kërkuar “Operatori ekonomike duhet te ofrojë Certifikata a) ISO 9001 2015 dhe b) ISO 13485 2016”, ne kemi kërkuar që të largohet nga dosja e tenderit ISO standardi 13485, pasi që i njëjti standard i kërkuar nuk përkon me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit. Autoriteti kontaktues në përgjigjen e tij e ka cekur si në vijim: ISO 9001 është për menaxhimin e kompanisë kurse ISO 13485 është për menaxhimin e produkteve mjekësore nga distributorët apo prodhuesit. Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se ne e kemi sqaruar në kërkesën për informacione shtesë se për çka dhe në cilat raste kërkohet ky standard. Standardi ISO 13485 shërbën sikurse në informatat në linkun e mëposhtëm: [https://www.rimsys.io/blog/iso-13485-overviewjavascript:nicTemp\(\);](https://www.rimsys.io/blog/iso-13485-overviewjavascript:nicTemp();) ose <https://13485store.com/medical-device-standards/what-is-iso-13485/> ose javascript:nicTemp() Shënim: ISO 13485 është për prodhues te Pajisjeve mjekësore dhe nuk është për OE dhe ne Kërkojmë që të detyrohet AK-ja të largoj nga dosja e tenderit kërkesën 1 për ISO 13485 sepse në këtë rast kemi te bëjmë

me OE qe kane për te furnizuar dhe jo me prodhues te pajisjeve mjekësore qe te kërkohet ISO 13485. Për me shume shiko faktet dhe dëshmitë për ISO 13485. Po ashtu ISO 13485 nuk duhet kërkohet për OE vendor sepse nuk janë prodhues te pajisjeve mjekësore sepse kjo certifikatë është vetëm për prodhues ose Anglisht: manufacture of medical devices, pra ISO 13485 Pajisjet mjekësore -- Sistemet e menaxhimit të cilësisë. Kërkesat për qëllime rregullatorë janë një standard, dhe përmban një sistem gjithëpërfshirës të menaxhimit të cilësisë për projektimin dhe prodhimi i pajisjeve mjekësore pra ky standard ISO 13485 vlen për PRODHUESIT E PAJISJEVE MJEKËSORE. 8/6 Pra nga të gjitha sqarimet e lartcekura kuptohet qartë se kërkesa sa i përket ISO 13485 është jo relevante me këtë aktivitet të prokurimit dhe e njëjta kërkesë favorizon OE të caktuar, andaj kërkohet që të largohet nga dosja e tenderit.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3 dhe 4.

Eksperti Shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor për ISO 13485, ka bërë një verifikim në internet ku fare lehtë është e verifikueshme vetëm me një kërkim me numer të ISO 13485, të cilat shihet që janë të natyrës për pajisje mjekësore, të bashkangjitura më poshtë të cilat i prezantoj për PSH. Pra kjo kërkesë e ISO standartëve 13485, lidhet me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor për nevojat e KPSH-së”, duhet të theksohet se Ak, ka vendosur fjalën ose 9001 2015, Quality Management Systems-Sistemet e menaxhimit të cilësisë. AK ka vepruar sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik neni, 5.5 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, si rregull i përgjithshëm është i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlershme/ekuivalente” si dhe Neni 5.3, një standard ndërkombëtarë dhe/ose, Re(5): Standarde ndërkombëtare janë për shembull ISO, www.iso.org, ASTM, www.astm.org, etj., Udhëzuesi Nr.001/2023. Andaj, në këtë rast nuk shoh që ka ndonjë favorizim apo diskriminim në lidhje me këtë pikë të ankesës.

5. Në lidhje me sqarimin tonë sa i përket pajisjes së kërkuar një Kamion 7.5T me rampe, autoriteti kontraktues ka dhënë përgjigjen si në vijim: Pajisjet e transportit janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Kamioni është mjet esencial për transportimin sidomos të infuzioneve (nacl, glucose, ringer) dhe ne e kemi paraparë që duhet në çdo qendër të liferohen dhe është shumë e vështirë për stafin teknik të QKMF-së të transportohet me dorë. Kjo kërkesë është mjaft bashkohore dhe e nevojshme të transportohen me transpaleta nga kamioni që ka liftin lëvizës (rampe). Ky sqarim i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, për faktin se ne, në sqarimin që e kemi bërë e kemi cekur qartë se kërkesa është kufizuese dhe diskriminuese/përkatësisht favorizuese, prandaj kemi kërkuar që të largohet kërkesa për Kamion 7.5 ton, dhe të lejohet një minimum real dhe i arsyeshëm i kamionit apo pajisjes për bartje. Autoriteti kontraktues përveç faktit që nuk e ka larguar kërkesën në lidhje me kamionin e njëjta nuk e ka lejuar as minimumin real dhe të arsyeshëm të kamionit/pajisjes për bartje. Kërkesa e autoritetit kontraktues për kamion me tonazhë strikt prej 7.5 tonë është kërkesë diskriminuese, dhe njëkohësisht kërkesë e cila favorizon një OE të caktuar i cili e posedon pajisjen e tillë ashtu siç e ka kërkuar autoriteti kontraktues. Kjo kërkesë bie në kundërshtim edhe me nenin 28 të LPP-së. Ne dy aktivitetet e kaluara që u përmenden tek pretendimi Nr.2 vetë autoriteti kontraktues kishte kërkuar: a) Së paku dy automjete (Pikap-KOMBI) për bartjen e mallit Tani për furnizime të njëjta e të ngjashme kërkon kamion e që realisht është i panevojshëm kamioni sepse furnizimi mund të kryhet edhe me makina më të vogla, por AK-së nuk i mjafton vetëm emërtimi dhe kërkesa kamion por edhe e saktëson 7.5 ton. Gjithashtu edhe në dy aktivitetet tjera të iniciuara nga AK-SHSKUK sa i përket pajisjeve edhe pse vlera e tenderi ka qenë shumë më e madhe dhe nuk janë kërkuar pajisje të tilla siç i ka kërkuar AK-ja në këtë aktivitet të prokurimit. Dy aktivitete të tjera të iniciuara nga SHSKUK të njëjta me këtë aktivitet të prokurimit, ku nuk është kërkuar kamion me tonazhë 7.5 ton: Aktiviteti prokurimit nr.1 AK: SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS Nr i prokurimit: 00220-22-2010-1-1-1 Titulli: “Furnizim me produktin Natrium Chloride nga Lista Esenciale për nevojat e SHSKUK-së” Vlera e parashikuar: 609,592.00€ (NaCl 0.9% 500ml me sasi 1,523,980 infuzione) Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 24 muajsh Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit: 16.03.2022 Aktiviteti

prokurimit nr.2 AK: SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS Nr i prokurimit: 00220-23-5371-1-1-1 9/6 Titulli: Furnizim me barna nga LE për SHSKUK-047 Vlera e parashikuar: Totali: 6 Lote-1,388,726.07 € (NaCl 0.9% 100ml me sasi 558,260 infuzione) Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 12 muajsh Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit: 26.05.2023.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, në lidhje me kërkesen e AK, për një Kamion 7.5T, eksperti shqyrtues mendon që kjo kërkesë nuk është diskriminuese/favorizuese, pasi që AK, nuk ka kërkuar emër të ndonjë marke të caktuar por vetëm peshën dhe i njejtë duhet të ketë liftin lëvizës (rampë), në këtë rast në kërkesë ju ka dhënë mundësi të ofertuesve nëse nuk e posedojnë një kamion të tillë mund të bëjnë marrëveshje për këtë shërbim. Andaj, eksperti shqyrtues mendon që kjo kërkesë e AK, të mbetet në fuqi pasi që konstatohet se kjo nuk ka të bëjë me ndonjë favorizim por, të gjitha palët e interesuara për këtë aktivitet të prokurimit mund të marrin lehtë ta plotësojnë këtë kërkesë, për ta kryer këtë shërbim mund të bëjnë marrëveshje me ndonjë pal tjetër, pasi që edhe vet AK, në dosje të tenderit ju ka lejuar këtë mundësi.

6. Në lidhje me kërkesën e dosjes së tenderit Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për furnizime në vlerë minimale në 3 (tri - 2020- 2021-2022) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) për 300.000,00 €, ne kemi kërkuar nga AK-ja sqarim se a pranohen raportet e pranimit të mallit për kontratat në vazhdim e sipër por që dëshmojnë furnizimet me fletëpranime të mallit dhe transaksione bankare. Autoriteti kontraktues nuk e ka lejuar një gjë të tillë, mirëpo vetëm e ka cekur që duhet të referohemi kërkesës së dosjes së tenderit. Ne edhe nga OSHP-ja kërkojmë që të detyrojmë AK-së të ndryshojë këtë kërkesë duke lejuar të prezantohen edhe raportet e pranimit të mallit për kontratat në realizim e sipër, të cilat furnizime dëshmojnë me fletëpranime të mallit dhe transaksione bankare, me qëllim që të hapet konkurrenca dhe mos të favorizohen OE të caktuar. Nëse nuk bëhet ndryshimi i kërkesës atëherë kufizohet konkurrenca dhe përveç faktit që diskriminohen OE më përvojë në këtë fushë, njëkohësisht ju pamundësohet ofertimi edhe OE të themeluar rishtazi. Për të dëshmuar përvojën e furnizimeve të kryera nuk duhet të vlejnjë vetëm kontrata sepse ka kontrata kornizë që zgjasin nga tri vite apo ka kontrata ndërkombëtare dhe që realisht janë të lidhur pa afat por dëshmojnë vetëm me fletëpranime dhe transaksione bankare, prandaj nuk duhet të mohohet rëndësia dhe vlera këtyre furnizimeve por duhet të pranohen si të tilla sepse dëshmojnë që janë kryer furnizimet me rregull. Ne me dt. 22.09.2023 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar. Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë sqarim më shumë se sa tek përgjigja në kërkesën për sqarime shtesë, e të cilat përgjigje ne i kontestuar më lartë në ankesë, prandaj konsiderojmë se AK-ja në mungesë të argumenteve për të arsyetuar kërkesat e dosjes së tenderit vetëm i ka përsëritur përgjigjet si tek sqarimet shtesë. Autoriteti kontraktues ka bërë shmangie gjatë përgjigjeve në pretendimet tona ankimore, pasi që për kamionin nuk përgjigjet rreth tonazhës strikte të kërkuar por flet për rëndësinë e kamionit që duhet për transport sidomos të infuzioneve. Në këtë dosje të tenderit kemi përshtatje të specifikimeve teknike dhe të kërkesave të FDT-së, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të detyrojë autoritetin kontraktues që të gjitha kërkesat e lartcekura, të cilat ne i kemi kontestuar të largohen nga dosja e tenderit me qëllim të hapjes së konkurrencës, pasi që kështu siç janë specifikuar kërkesat po diskriminohen shumë OE me përvojë në këtë fushë, të cilët janë të interesuar për të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit. Këto kërkesa bien ndesh plotësisht edhe me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por 10/6 do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktivitetit të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”. Me këto kërkesa, jo që nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë

drejtpërdrejtë jo në harmoni me qëllimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa arsyeshme dhe të nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë, sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet fituesi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit. Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezultojnë se nuk është përpiluar dosja e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr parasysh as neni 17.17 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”. Pra duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë, kuptohet që dosja e tenderit e kufizon konkurrencën dhe favorizon një ose më tepër operator ekonomik. Neni 25.6 i Rregullores për prokurim publik nr.001/2022 e parasheh qartë “Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë. Në këtë tender kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit nuk janë proporcionale me objektin e kontratës dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit dhe janë kërkesa të panevojshme. Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit edhe shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”. Me këto kërkesa, jo vetëm që nuk i është kushtuar rëndësi operatorëve ekonomik të ri, por i është kufizuar konkurrenca edhe operatorëve ekonomik me përvojë dhe me stabilitet ekonomik financiar dhe me aftësi teknike profesionale, prandaj duhet ndryshuar/larguar këto kërkesa që të mundësohet pjesëmarrje më e gjerë e operatorëve ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit dhe të merret parasysh edhe dispozita e lartpërmendur (25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik). Autoriteti kontraktues në vend se të ketë parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinjë, përveç se nuk është marr parasysh kjo dispozitë, janë diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në këtë fushë. Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuar 11/6 më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara. Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezultojnë se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Përgjigje në pretendimin nr.6

Sa i përket pretendimit ankimor nr. 6, lidhur me qarkullimin bankar si dhe referencat për tri vitet e fundit Eksperti Shqyrtues konstaton se AK, ka vepruar konform LPP, si dhe rregullave të prokurimit publik konkretisht Udhëzuesi Nr. 001/2023 faqe 31, "Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “ të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “ në periudhën e shkuar trevjeçare...”). Ne kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: “ periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlihdet me periudhën që paraprind datën e publikimit të njoftimit për kontratë”. Ndërsa sa i përket kërkesës të AK, Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për furnizime në vlerë minimale për (3)tri vitet e fundit 300.000,00 euro, Në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kërkesa për qarkullim duhet të shprehet detyrimisht në shifra dhe duhet të referohet maksimum tri viteve të fundit financiare. Vitet e tilla financiare duhet të përcaktohen qartë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tender ose pjesëmarrje. Kur, përveç qarkullimit minimal,një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i

nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës.për këtë pikë kërkesa është e bazuar. Andaj, eksperti shqyrtues mendon që kërkesa e dosjes së tenderit të AK, lidhur me këtë pretendim ankimor është kërkesë e bazuar, ndërsa pretendimi ankimor i OE mendon qe është i pabazuar.

- Konstatimet e panelit shqyrtues -

Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesën në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar nga ana e këtij Paneli.

Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertëve shqyrtues (profesional dhe teknik) janë dhenë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim. Andaj përfundimisht PSH ka vendosur se, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kritere diskriminuese, PSH mbështetet në raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues të caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tij profesional është se kërkesa e cekura në pretendimet ankimor të OE ankues, si të tilla paraqesin diskriminim, andaj PSH obliguon AK që të bëhen përmirësimet konform vlerësimit të ekspertit shqyrtues, të bëra në raportin e ekspertizës. Kështu që, rekomandimi i ekspertit shqyrtues të cilin në këtë rast PSH ja fal besimin është që ankesa të klasifikohet si e pa bazuar dhe AK të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit..

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se një pjesë e pohimeve ankimore janë të pa bazuara, sikurse është shpjeguar dhe si më sipër, kurse AK ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenet 7, 27 dhe 28 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, pa fakte dhe prova dhe/ose pa bazë ligjore, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - MEDPLUS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: